

## NJOFTIM PUBLIK

(AP20\_003)

### STUDIM I TREGUT PËR PËRZGJEDHJEN E OPERATORËVE EKONOMIKË QË DO TË FTOHEN PËR TË PARAQITUR OFERTË PËR SHËRBIMET NË KUADËR TË PROJEKTIT TË BINJAKËZIMIT, AL 17 IPA JH 01 19 NË SHQIPËRI

#### AUTORITETI KONTRAKTOR

CSI-Piemonte, C.so Unione Sovietica 216, 10134 - Torino, Itali

e-mail: [acquisti\\_spfm@csi.it](mailto:acquisti_spfm@csi.it), faqja zyrtare: [www.csipiemonte.it](http://www.csipiemonte.it).

Më shumë informacion mund të gjendet në pikat e kontaktit të sipërcituara.

#### SEKTORI

Shërbimet

#### PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

CSI Piemonte po zbaton aktualisht projektin e Binjakëzimit të financuar nga BE-ja me titull AL 17 IPA JH 01 19 "Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me *acquis* të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale".

Projekti ka filluar që prej 1 tetorit 2020 dhe do të përfundojë në 30 shtator 2021. Ai synon forcimin e kapaciteteve institucionale të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë, për mbikëqyrjen dhe monitorimin e mbrojtjes së të dhënave personale, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Objektivi specifik i projektit është të mbështesë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë, në përafrimin e legjislacionit kombëtar në fuqi, dhe konkretisht të Ligjit Nr. 9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", të ndryshuar, me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare për të zbatuar *acquis* përkatëse të Bashkimit Evropian.

CSI Piemonte po kërkon Ofrues të Shërbimeve në mënyrë që të mbështesë zbatimin e projektit me një ekspertizë të veçantë mbi komunikimin dhe vizibilitetin, identitetin vizual, interpretimin e përkthimin dhe kateringun.

Të gjitha shërbimet e konceptimit grafik dhe materialet e botuara duhet të zhvillohen në përputhje me udhëzuesin për komunikimin të BE-së.

Nga kërkuesit do të kërkohet që të ofrojnë shërbime në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e projektit dhe të gjitha produktet dhe modelet përfundimtare do të aprovohen nga CSI Piemonte përpara se t'i konsiderojnë të plota. Prokurimi i shërbimeve do të mbulohet nga buxheti i projektit të Binjakëzimit AL 17 IPA JH 01 19.

## **KUADRI LIGJOR**

- Rregullore (BE, EURATOM) 2018/1046 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 18 korrikut 2018 që përcakton rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, duke amenduar rregulloret (BE) nr. 1296/2013, (BE) nr. 1301/2013, (BE) n. 1303/2013, (BE) nr. 1304/2013, (BE) nr. 1309/2013, (BE) nr. 1316/2013, (BE) nr. 223/2014, (BE) nr. 83/2014 dhe vendimin nr. 541/2014 / BE dhe shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom) nr. 966/2012.
- Për çdo gjë që nuk parashikohet shprehimisht nga legjislacioni i sipërpërmendur, duhet t'u referohen parimeve të Dekretit Legjislativ nr. 50/2016 “Kodi i Kontratave Publike 2 dhe rregulloret e brendshme të CSI-së.

## **SHËRBIMET (OBJEKTI I KONTRATËS)**

1. Shërbim catering: pushim kafeje për 2 aktivitete që do të mbahen në Tiranë si pjesë e projektit për periudhën janar - shtator 2021;
2. Shërbim interpretimi dhe shërbim përkthimi: interpretim simultan dhe konsektiv nga gjuha angleze/italiane në gjuhën shqipe gjatë aktiviteteve dhe seminareve të projektit; shërbimi i përkthimit të dokumenteve të projektit nga anglishtja/italishtja/gjermanishtja në shqip dhe anasjelltas. Shërbimi i interpretimit mund të duhet të kryhet në distancë nëpërmjet platformës së video-konferencës. Shërbimet do të ofrohen në periudhën janar - shtator 2021;
3. Shërbim printimi dhe lidhjeje të dokumentacionit të projektit. Shërbimi do të ofrohet në periudhën janar-shtator 2021;
4. Shërbimi i konceptimit të identitetit vizual të projektit dhe furnizimi me pajisje kancelarie të personalizuar. Shërbimi do të zbatohet në përputhje me Udhëzuesin për Komunikimin të BE-së<sup>1</sup> dhe do të përmbajë logot e projektit, BE-së dhe partnerëve; duhen kryer në të dy gjuhët zyrtare të projektit (anglisht dhe shqip) dhe duhen ofruar në periudhën janar - shtator 2021.

## **VENDI KU DO TË KRYHEN SHËRBIMET**

**Tiranë – Shqipëri**

---

<sup>1</sup> [https://ec.europa.eu/international-partnerships/comm-visibility-requirements\\_en](https://ec.europa.eu/international-partnerships/comm-visibility-requirements_en)

## **OBJEKTI**

Nëpërmjet këtij njoftimi publik, CSI-Piemonte nis një studim tregu që synon përzgjedhjen e Operatorëve Ekonomikë që do të ftohen të paraqesin ofertën për shërbimet që do të kryhen në kuadër të Projektit të Binjakëzimit AL 17 IPA JH 01 19 në Shqipëri.

Procedurat e aplikimit për secilin shërbim do të detajohen në kërkesën për ofertë, e cila do të dërgohet me e-mail, përfshirë specifikimet teknike dhe listat e çmimeve.

Priten të paktën 3 aplikime për secilin shërbim.

Nëse numri i aplikimeve që plotësojnë kriteret është:

- më pak se 3, CSI Piemonte ka të drejtën për të vijuar me kërkesën për ofertë;
- më i lartë se 12, CSI Piemonte ka të drejtën për të dërguar një kërkesë për ofertë për të gjithë kandidatët, ose të vazhdojë me hedhjen e shortit.

Procedurat për kryerjen e çdo shorti do të publikohen në faqen zyrtare të CSI Piemonte.

## **PËRGJEGJËS PËR PROCEDURËN**

Riccardo Palumbo

### **VLERA E PARASHIKUAR**

1. Shërbimi catering: 660,00 Euro (përveç tarifave të detyrueshme me ligj, përfshirë kostot e sigurisë lidhur me ndërhyrjet që nuk i nënshtrohen një uljeje të barabartë me 0,00 Euro);
2. Shërbim interpretimi dhe shërbim përkthimi: shuma totale e barabartë me 5,280,00 Euro (përveç tarifave të detyrueshme me ligj, përfshirë kostot e sigurisë lidhur me ndërhyrjet që nuk i nënshtrohen një uljeje të barabartë me 68,00 Euro);
3. Shërbim printimi dhe lidhjeje të dokumentacionit të projektit: shuma totale e barabartë me 1,275,00 Euro (përveç tarifave të detyrueshme me ligj, përfshirë kostot e sigurisë lidhur me ndërhyrjet që nuk i nënshtrohen një uljeje të barabartë me 0,00 Euro);
4. Shërbimi i konceptimit të identitetit vizual të projektit dhe furnizimi me pajisje kancelarie të personalizuar: shuma totale 3,550.00 Euro (përveç tarifave të detyrueshme me ligj, përfshirë kostot e sigurisë lidhur me ndërhyrjet që nuk i nënshtrohen një uljeje të barabartë me 0.00 Euro).

## **KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT**

Duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës së Shërbimit deri në datën 30 shtator 2021.

## KËRKESAT MINIMALE

Për të marrë pjesë në studim, Operatorët Ekonomikë duhet të deklarojnë se plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në "Formularin e Aplikimit" (Shtojca A).

Këto kërkesa janë:

- mungesa e pengesave për kontraktimin me administratën publike;
- regjistrimi në Dhomën e Tregtisë ose në një organ ekuivalent, për operatorët që nuk ndodhen në Itali;
- deklarata e ekzekutimit të shërbimeve të ngjashme.

CSI-ja ka të drejtën për të verifikuar vërtetësinë e deklaratave të bëra nga operatorët ekonomikë, duke kërkuar gjithashtu sqarime direkt nga operatorët, nëse është e nevojshme. Nëse vërtetohet pavërtetësia e asaj që është deklaruar në "Formularin e Aplikimit", operatori ekonomik nuk do të ftohet të paraqesë ofertën.

## DORËZIMI I APLIKIMIT

Ky njoftim është i vlefshëm deri më **14/12/2020** në:

- faqen zyrtare të CSI-Piemonte: <https://www.csipiemonte.it/web/it/fornitori-gare/indagini-mercato>);
- faqen e internetit të Përfituesit "Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë (IPA)" - nëpërmjet lidhjes në faqen e internetit të CSI Piemonte;
- në faqen zyrtarë të ambasadës në Tiranë – nëpërmjet lidhjes në faqen e internetit të CSI Piemonte.

Në këtë kuadër, aplikimet do të dërgohen deri më **14/12/2020 në orën 12:00 CET** nëpërmjet e-mail-it në adresën si vijon: [acquisti\\_spfm@csi.it](mailto:acquisti_spfm@csi.it).

Formulari i aplikimit që duhet të plotësohet (Shtojca A "Formulari i aplikimit"), gjendet në lidhjen si vijon: (<https://www.csipiemonte.it/web/it/fornitori-gare/indagini-mercato>). Kandidatët duhet të shkruajnë në subjektin e e-mail-it kodin e identifikimit të këtij Njoftimi Publik (AP20\_003).

Aplikimet që do të vijnë pas kësaj date nuk do të merren në konsideratë.

Dokumentacioni për kërkesën për ofertë në lidhje me secilin shërbim (specifikimet teknike dhe lista relative e çmimeve) do t'u dërgohet vetëm dhe ekskluzivisht operatorëve ekonomikë që:

- kanë dorëzuar aplikimin e tyre në përputhje me termat dhe procedurat e lartpërmendura;
- plotësojnë "Kërkesat minimale" sikurse përmendet më lart, bazuar në deklaratat e përfshira në aplikim.

Kandidatët mund të depozitojnë aplikimin e tyre për një ose më shumë shërbime. Aplikimi për një shërbim nuk e përjashton kandidatin nga aftësia për të tenderuar për më shumë se një shërbim ose për të gjitha shërbimet.

Megjithatë, kandidati (kërkuesi) duhet të paraqesë një kërkesë të veçantë për secilin shërbim (p.sh. tre shërbime, tre aplikime të ndryshme), pasi nuk lejohet një aplikim i vetëm për tre shërbime të ndryshme.

I njëjti parim do të zbatohet edhe për paraqitjen e ofertës: në rast të pjesëmarrjes në disa shërbime, kandidati (kërkuesi) duhet të paraqesë një ofertë të veçantë për secilin shërbim në të cilin është ftuar operatori (p.sh. pjesëmarrja në tre shërbime të ndryshme: paraqitja e tre ofertave, një për secilin shërbim).

Aplikimet, ofertat dhe çdo dokument tjetër kontraktual do të jetë në anglisht.

Shumat e treguara në oferta do të shprehen në euro (EUR).

### **KËRKESAT PËR SQARIME**

Çdo kërkesë teknike dhe/ose administrative për sqarim në lidhje me këtë studim dhe dokumentacionin përkatës do të dërgohen në adresën e e-mail si vijon: [acquisti\\_spfm@csi.it](mailto:acquisti_spfm@csi.it), deri më **10/12/2020 në 16:00 CET.**

Pyetjet dhe përgjigjet do të publikohen në faqen e internetit të Konsorciumit [www.csipie-monte.it](http://www.csipie-monte.it) në mënyrë anonime, në faqen "Furnizuesit dhe tenderët - Studimet e Tregut", në seksionin kushtuar këtij studimi deri më **11/12/2020.**

Prandaj ju ftojmë të konsultoni faqen herë pas here.

Personi Përgjegjës për Procedurën do të shqyrtojë aplikimet dhe do të hartojë një raport.

### **INFORMACION SHITESË**

Publikimi i këtij Njoftimi në lidhje me zgjedhjen e Operatorëve Ekonomikë që do të ftohen të paraqesin ofertë, nuk përbën një propozim kontraktual dhe në asnjë mënyrë nuk e detyron CSI Piemonte, i cili do të jetë i lirë të dërgojë ose jo kërkesa për oferta.

CSI Piemonte ka të drejtën të ndërpresë procedurën në çdo kohë, për arsye të kompetencës së saj ekskluzive, pa i dhënë mundësi kandidatëve të paraqesin pretendime, përfshirë dëmshpërblimin, rimbursimin ose kompensimin.

*Publikuar ne 04/12/2020*

RUP

Riccardo Palumbo